



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government



Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stok Company

Në bazë të nenit 10 të Ligjit nr.05/L-120 për Trepçën, nenin 21 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 lidhur me nenin 22 paragrafi 3 i Statutit të Trepça Sh.A, nenin 20 paragrafi 7 Rregulloren për Marrëdhënie Pune në Trepça Sh.A, Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A me datë 05.06.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anulohet konkursi për pozitën Përgjegjës i dromcores primare në njësinë biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë;
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar në Rregulloren për Marrëdhënie Pune në Trepça Sh.A., përkatësisht nenin 20 paragrafi 7, i cili përcakton se “kontrata e punës nënshkruhet në afat prej 3 (tri) ditësh pas marrjes së vendimit nga Komisioni i Ankesave”, është konstatuar se nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për lidhjen e kontratës së punës brenda afatit të përcaktuar me rregullore.

Vendimi për përzgjedhjen e kandidatit për pozitën Përgjegjës dromcores primare në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë është nxjerrë më datë 22.05.2026. Afati për paraqitjen e ankesave ka qenë 8 (tetë) ditë dhe ka përfunduar më datë 01.06.2026, ndërsa kontrata e punës është dashur të nënshkruhet brenda 3 (tri) ditëve nga përfundimi i këtij afati, respektivisht deri më datë 04.06.2026.

Meqenëse afati i përcaktuar me rregullore ka kaluar pa u lidhur kontrata e punës dhe procedura e rekrutimit nuk mund të finalizohet në përputhje me dispozitat e brendshme në fuqi, është krijuar bazë për anulimin e konkursit për këtë pozitë. Për këto arsye, Kryeshefi Ekzekutiv ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryeshefi Ekzekutiv

Faton Ahmeti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit Komisionit të Ankesave të Trepça Sh.A

Me këtë vendim të njoftohen:

- Departamenti i Burimeve Njerëzore
- Arkivi i Trepça Sh.A